



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

22-05-2012

| Prokur - Prokurimi Mësimor | Shifra | Vlera |
|----------------------------|------------|------------------|
| Nr i organit Org broj | Numri/Broj | Shifra Prilog |
| 01-013/642 | | Vrednost |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d), nenit 17 parag. 3 lidhur me nenin 58 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovë (Gazeta zyrtare nr 28/2008), Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së pa luajtshme (G. zyrtare e Republikës së Kosovës nr 89/2010), nenit 13 pika 2 e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr 2012/02 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së pa luajtshme të komunës, dhe dispozitave të nenit 36 paragrafi 2 lidhur me nenin 35 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 16 maj 2012 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR FILLIMIN E NEGOCIATAVE
PËR KËMBIMIN E PRONËS KOMUNALE ME ATË TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE TË
MENAXHUARA NGA AGJENSIONI KOSOVAR I PRIVATIZIMIT

Neni 1

Autorizohet Kryetari i Komunës së Vitisë për fillimin e negociatave për këmbimin e pronës komunale me atë ndërmarrjeve shoqërore e cila menaxhohet nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP).

Neni 2

Ndërrimi/këmbimi i pronës së pa luajtshme të komunës do të bëhet për interesin e përgjithshëm të Komunës së Vitisë dhe qytetarëve të saj, duke respektuar procedurën ligjore.

Neni 3

Negocimi i këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e ndërmarrjeve shoqërore që menaxhohet nga AKP do të bëhet për ngastrat e poshtëshënuara:

Ngastra me Nr 2059/10 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 2485 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 2495 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 969/1 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 2496/1 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 2496/2 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 2484/1 Zona kadastrale –Viti,

Ngastra me Nr 2484/11 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 2484/12 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 346/1 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 3461/1 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 3461/50 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 2487/1 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 2487/11 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 968/0 Zona kadastrale –Viti,
Ngastra me Nr 596/1 Zona kadastrale –Drobesh,
Ngastra me Nr 596/2 Zona kadastrale –Drobesh,
Ngastra me Nr 596/3 Zona kadastrale –Drobesh,
Ngastra me Nr 576 Zona kadastrale –Drobesh, dhe
Ngastra me Nr 443/2 Zona kadastrale –Drobesh,

Neni 4

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi e bënë Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, si dhe vlerësimin të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

01 Nr _____
Viti, 17 maj 2012

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Skenderbe Hebibi

